



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2024:041373

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05515067

P.nr.25/2024

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë – Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal, përmes gjyqtarit **Sadri Krasniqi**, me procesmbajtësen **Donjeta Zenuni**, në lëndën penale kundër të akuzuarit, Sh. Sh. nga, për shkak të veprës penale: Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 3 dhe 2 të KPRK-së, të cilin sipas autorizimit e mbron av. Ramadan Leka nga Gjilani, duke vendosur sipas aktakuzës së PTH-së nga Gjilani, PP.II.nr.227/2024 të datës 16.02.2024, pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin e Marrëveshjes për pranimin e fajësisë, më datën 20.03.2024, në prani të Prokurores së Shtetit, Leonora Kadriu, të akuzuarit Sh. Sh. dhe mbrojtësin e tij av. Ramdan Leka, shpalli dhe publikisht komunikoi, ndërsa më datën 27.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I a k u z u a r i :

Sh.Sh., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati A. dhe e ëma S.e lindur Q., i lindur më dt., në me numër personal shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, sipas deklaratës së tij i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër për veprë tjetër penale.

Është fajtor

Sepse:

Se me date 17.10.2023, rreth orës 15:00, në ish objektin e fabrikës së pllakave “XIQ Karaqeve”, në fshatin, i pandehuri Sh. Sh., në cilësinë e pronarit të firmës SHPK “M-Sh.”, me seli në, nuk ka vepruar ne pajtim me dispozitat apo rregullat teknike mbi masat për sigurinë në vendit e punës, siç parashihen në nenin 6 par.1 dhe 7 par.1 nën par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe me këtë ka rrezikuar jetën e njerëzve, në atë mënyrë që nuk ka krijuar kushtet e sigurta të punës dhe si pasojë e kësaj neglizhence, punëtori-tani i dëmtuari F. H., përderisa ishte duke punuar në grumbullimin e hekurishteve në vendin e punës, ka pësuar lëndime të rënda trupore nga një pjesë e llamarinës, e cila i kishte rënë nga qatia e objektit në këmbën e tij të majtë, i cili është detyruar të kërkoj ndihmë mjekësore në Spitalin Rajonal të Gjilanit.

- me çka ka kryer veprën penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 paragraf 5 lidhur me paragraf 3 dhe 2 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u mbështetur në nenin 4, 38, 42, 43, 44, 69, 70, 71 dhe 72, paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të KPRK-së, lidhur me nenin 230, 364 dhe 449 të KPPRK-së, të akuzuarin e,

G J Y K O N

- dënim burgu efektiv në kohëzgjatje prej nga **nëntëdhjetë (90) ditëve**, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit, e në kuptim të nenit 44 të KPRK-së do t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën prej **1200 €**, të cilën shumë, do ta arkëtoi në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, **në tri këste mujore**, në të kundërtën i njëjti dënim me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgu ashtu që për çdo 20 €, do t'i llogaritet nga një ditë burgu.

Pala e dëmtuar, F.H., nga për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari, që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej nga 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Njashtu të akuzuarit obligohen që në kuptim të nenit 36, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguajnë shumën prej nga 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, me aktakuzën PP.II.nr.227/2024 të datës 16.02.2024, i ka propozuar gjykatës që ndaj të akuzuarit, Sh. Sh. nga”, te banesat e Cenit, të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të veprës penale: sgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 3 dhe 2 të KPRK-së, të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit. Së bashku me aktakuzën Prokuroria e Shtetit ka parashtruar dhe Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë së hartuar nga ana e Prokurorisë së Shtetit - Prokuroria Themelore në Gjilan, në njërën anë dhe të akuzuarit Sh. Sh.i me mbrojtësin e tij me sipas autorizimit av. Ramadan Leka, në anën tjetër.

Në marrëveshjen për pranimin e fajësisë të hartuar ndërmjet palëve, respektivisht Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe të akuzuarit Sh. Sh. me mbrojtësin e tij me sipas autorizimit av. Ramadan Leka, palët kanë përcaktuar edhe kushtet e pranimit të fajësisë, ku ndër të tjera është negociuar dhe propozuar dënimi me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve , i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit, konform nenit 44 të KPRK-së do të zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 1200 euro.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë, pas vlerësimit të së njëjtave dhe shkresave tjera të lëndës konstatoi se të njëjtat janë të bazuara në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtave, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë kundër të akuzuarit për datë 20.03.2024, në të cilën seancë gjyqësore, Prokurorja e shtetit Leonora Kadriu, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës dhe marrëveshjes së lidhur me të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij e lidhur në Prokurorin Themelore në Gjilan-Departamenti i përgjithshëm, PP.II.nr.227/2024 të datës 15.02.2024, për shkak të veprës penale: Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës, nga neni 358 par.5 lidhur me par.3 dhe 2 të KPRK-së, nga fakti se i akuzuari në prezencën e mbrojtësit të tij av. Ramadan Leka, në mënyrë vullnetare pa shtrëngim apo nën presion në tërësi ka pranuar benefitet dhe pasojat e kësaj marrëveshje.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë PP.II.nr.227/2024 është hartuar me datën 15.02.2024, në mënyrë vullnetare nga të pranishmit dhe e pranuar nga i akuzuari Sh. Sh., në tërësi si marrëveshje me të gjitha pikat dhe konditat e saj.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. Ramdan Leka dhe i akuzuari Sh.Sh., deklarojnë se në tërësi mbesin pranë marrëveshjes së nënshkruar dhe pranuar nga i akuzuari dhe njëkohësisht i propozuan gjykatës që ta aprovoj në tërësi marrëveshjen me të gjitha elementet - kushtet e saj, po ashtu kësaj gjykate i propozuan që të akuzuarit dënimin me gjobë t'ia mundësojë që ta paguajë me këste mujore.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga i akuzuari, respektivisht nga vetë përmbajtja dhe kushtet e pranimit të marrëveshjes së pranimit të fajësisë, ku i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata, sipas detyrës zyrtare e në harmoni me nenin 251 të KPPRK-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa-pranueshme dhe e marrë në kundërshtim me dispozitat e nenit të lartë-theksuar e cila do të vinte në mëdyshje dhe do të bënte të papranueshëm pranimin e fajësisë. Gjithashtu, gjykata konsideroi se nuk ekzistojnë rrethana të përcaktuara nga neni 244 të KPPRK-së të cilat do të konsistonin në krijimin e situatës dhe rrethanave për hedhjen e aktakuzës.

Gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes së pranimit të fajësisë, gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën-pasojat e marrëveshjes për pranimin e fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë. Marrëveshja për pranimin e fajësisë, respektivisht pranimi i fajësisë nga i njëjti është bërë në mënyrë vullnetare, pa kushtëzim, pa presion, askush nuk ia ka bërë ndonjë premtim të kundërligjshëm i cili do ti shtyjë në pranimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, heqin dorë nga e drejta në gjykim të rregullt, respektivisht nga të gjitha të drejtat që kanë të bëjnë me gjykimin e rregullt, pas konsultës së mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe në harmoni me dispozitat e neneve 230, 240 dhe 242 të KPPRK-së.

Ndërsa sa i përket dënimit dhe vendimit për dënimin, Prokurorja e Shtetit, Leonora Kadriu, i akuzuari Sh.Sh. dhe mbrojtësi i tij av.Ramadan Leka, i propozuan gjykatës që ta aprovoj dënimin e përcaktuar në marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Gjykata duke marrë në konsideratë rrethanat të cilat ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, respektivisht rrethanat e përcaktuara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, erdhi në përfundim se dënimi i propozuar nga palët është dënim i cili i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale të tij-akuzuarit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi preventiv i dënimit, respektivisht që në të ardhmen i akuzuari të jetë më i përgjegjshëm dhe të përmbahet nga veprimet e këtilla.

Gjatë vendosjes për dënimin, gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë të veçantë rënduese e cila do të ndikonte në llojin dhe lartësinë e dënimit, ndërsa si rrethana tejet lehtësuese ka konsideruar: pranimin e fajësisë nga i akuzuari, ku këtë gatishmëri të pranimit të fajësisë i njëjti e ka shprehur që në fazat e hershme hetimore me lidhjen marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Andaj, bazuar në rrethanat e lartë-theksuara gjykata ka aprovuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë në tërësi me të gjitha elementet e saja, respektivisht ka aprovuar dënimin me burgim prej nëntëdhjetë (90) ditëve, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit, konform nenit 44 të KPRK-së do të zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 1200 euro, dënim i cili ka për tu ekzekutuar pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Andaj bazueshëm mund të pritët që ky dënim do të ndikoj pozitivisht në përmirësimin e të akuzuarit, do të ketë ndikim edukativ edhe ndaj qytetarëve tjerë që në të ardhmen mos të kryejnë vepra penale, sikundër që do t'i kontribuojnë disiplinës dhe përgjegjësisë më të madhe të qytetarëve në përgjithësi.

Pala e dëmtuar, F. H., nga për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, gjykata, bazuar në nenin 452 paragrafi 1 KPP-së-së, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (Njëzetë euro), si dhe 20 € për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2024:041373, 27.03.2024

G j y q t a r i,

Sadri Krasniqi,d.v.

Këshilla Juridike : Ky aktgjykim është i plotfuqishëm që në datën e shpalljes-publikimit të tij, pasi që palët kanë hequr dorë nga e drejta e ushtrimit të ankesës ndaj të njëjtit.